

PHILIPS

Soundbar

Seria 7000

TAB7207



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	Udhëzime të rëndësishme sigurie	3
	Siguria	3
	Kujdesi për produktin tuaj	4
	Kujdesi për mjedisin	4
	Pajtueshmëria	4
	Ndihmë dhe mbështetje	4

2	Soundbar juaj	6
	Çfarë ka në kuti	6
	Njësia kryesore	6
	Konektorët	7
	Subwoofer me valë	7
	Telekomanda	8
	Përgatitja e telekomandës	8
	Vendosja	9
	Montimi në mur	10

3	Lidhja	11
	Dolby Audio	11
	Lidhja me portën HDMI ARC	11
	Lidhja me portën Optical	12
	Lidhja me portën AUX	12
	Lidhja me energjinë	13
	Lidhja me subwoofer	13

4	Përdorimi i soundbar tuaj	14
	Ndezja dhe fikja	14
	Zgjedhja e efektit të ekualizuesit (EQ)	14
	Rregullimi i volumit	15
	Rivendosja e parametrave të fabrikës	15
	Punimi me Bluetooth	16
	Punimi me USB	17
	AUX / OPTICAL / HDMI	
	Punimi me ARC	17

5	Të dhëna për produktin	18
----------	-------------------------------	-----------

6	Zgjidhja e problemeve	19
	Trademarks	21

1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

Lexoni dhe kuptoni të gjitha udhëzimet para se ta përdorni produktin. Garancia nuk është e vlefshme nëse dëmtimi shkaktohet nga mosndjekja e udhëzimeve.

Siguria

Rrezik goditjeje elektrike ose zjarri!

- Para se të bëni ose të ndryshoni ndonjë lidhje, sigurohuni që të gjitha pajisjet të jenë të shkëputura nga priza.
- Asnjëherë mos e ekspozoni produktin dhe aksesoret në shi ose në ujë. Asnjëherë mos vendosni enë me lëngje, si për shembull vazo, pranë produktit. Nëse mbi produkt ose brenda produktit derdhen lëngje, hiqeni nga priza menjëherë. Kontaktoni shërbimin e kujdesit ndaj klientit për ta kontrolluar produktin para se ta përdorni.
- Asnjëherë mos e vendosni produktin dhe aksesoret pranë flakëve të ndezura ose pranë burimeve të tjera të nxehtësisë, përfshirë edhe dritën direkte të diellit.
- Asnjëherë mos futni objekte në vrimat e ajrimit ose në vrima të tjera në produkt.
- Aty ku spina e energjisë ose një bashkues i pajisjes përdoret për si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.
- Bateria e brendshme nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësive të tepërta si për shembull drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Shkëputeni produktin nga priza kur ka stuhi me vetëtimat.
- Kur shkëputni kordonin e energjisë, gjithmonë tërhiqni spinën, asnjëherë kabullin.
- Përdorimi i produktit në klima tropikale dhe/ose mesatare.

Rrezik për qark të shkurtër ose zjarr!

- ër identifikimin dhe të dhënat për energjinë, shikoni etiketën e të dhënave mbrapa ose poshtë produktit.
- Para se ta lidhni produktin në prizë, sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me vlerën që është printuar mbrapa ose poshtë produktit. Asnjëherë mos e lidhni produktin me një prizë energjie nëse tensioni është i ndryshëm.

Rrezikoni të lëndoheni ose ta dëmtoni këtë produkt!

- Për montimin në mur, ky produkt duhet të fiksohet mirë në mur sipas udhëzimeve për instalimin. Përdorni vetëm kllapën e dhënë për montimin në mur (nëse ka). Montimi i papërshtatshëm në mur mund të shkaktojë aksidente, lëndime ose dëmtime. Nëse keni ndonjë pyetje, kontaktoni shërbimin e klientit në vendin tuaj.
- Asnjëherë mos e vendosni produktin ose ndonjë objekt mbi kordonët e energjisë ose mbi pajisje të tjera elektrike.
- Nëse produkti transportohet në temperatura nën 5 °C, shpaketojeni produktin dhe prisni që temperatura të jetë njëlloj me temperaturën e ambientit para se ta lidhni në prizë.
- Disa pjesë të këtij produkti mund të jenë prej qelqi. Kapeni me kujdes për të shmangur lëndimet dhe dëmtimet.
- Ju lutemi ta përdorni produktin në mënyrë të sigurt në ambient me temperaturë ndërmjet 0 °C dhe 40 °C.

Rrezik nxehtësie të lartë!

- Asnjëherë mos e instaloni këtë produkt në hapësirë të kufizuar. Gjithmonë lini të paktën katër inç hapësirë anëmbanë produktit për ajrim të mirë. Sigurohuni që perdet ose objektet e tjera të mos mbulojnë asnjëherë vrimat e ajrimit në produkt.

Rrezik ndotjeje!

- Mos i përzieni bateritë (të rejat me të vjetrat, ose ato prej karboni me ato alkaline, etj.).

- **KUJDES:** Rrezik shpërthimi nëse bateritë nuk vendosen si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Hiqini bateritë nëse janë shkarkuar ose nëse telekomanda nuk do të përdoret për kohë të gjatë.
- Bateritë përmbajnë substanca kimike, ndaj duhet të hidhen si duhet.



Ky është një aparat i KLASIT II me izolim të dyfishtë, dhe nuk ka tokëzim mbrojtës.



Tensioni AC



Ndiqui udhëzimet në manualin e përdorimit!



PARALAJMËRIM!

Paralajmërim: Rrezik goditjeje elektrike!



Shenja e pikëpyetjes ka për qëllim të lajmërojë përdoruesin për praninë e udhëzimeve të rëndësishme të përdorimit.



Shënim

- Etiketa e vlerave është e ngjitur poshtë ose mbrapa pajisjes.

Kujdesi për produktin tuaj

Përdorni vetëm leckë mikrofibër për ta pastruar produktin.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit dhe baterisë së vjetër



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga European Directive 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga European Directive 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake.

Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqui rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Hegja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën për montimin e baterive.

Deklarata e konformitetit

Ky produkt i përmbahet kërkesave të Komunitetit Evropian për interferencat radio. MMD Hong Kong Holding Limited deklaron këtu se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të RED Directive 2014/53/EU dhe UK Radio Equipment Regulations SI 2017 No 1206. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.

Ndihmë dhe mbështetje

Për ndihmë të mëtejshme online, vizitoni www.philips.com/support:

- shkarkoni manualin e përdorimit dhe udhëzuesin e shkurtër
- shihni video udhëzuese (vetëm për disa modele të caktuara)

- gjeni përgjigje për pyetje të bëra shpesh (FAQs)
- na dërgoni pyetje me email
- bisedoni me përfaqësuesit tanë.

Ndiqui udhëzimet në faqen e internetit për të zgjedhur gjuhën, dhe më pas vendosni numrin e modelit të produktit.

Përndryshe mund të kontaktoni kujdesin ndaj klientit në vendin tuaj. Para se të kontaktoni, mbani shënim numrin e modelit dhe numrin e serisë së produktit. Mund t'i gjeni këto informacione mbrapa ose poshtë produktit.

Informacione FCC

SHËNIM: Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje digjitale të Klasit B, sipas pikës 15 të rregullave FCC. Këto limite janë vendosur për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencave të dëmshme në një ambient banimi. Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas udhëzimeve, mund të shkaktojë interferenca të dëmshme ndaj komunikimeve radio.

Megjithatë, nuk ka garanci se nuk do të ketë interferenca në një ambient të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke e fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi nxitet që të përpiqet ta korrigjojë interferencën duke ndjekur një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Ndryshoni orientimin ose zhvendosni antenën.
- Largoni distancën mes pajisjes dhe marrësit.
- Lidhni pajisjen në një prizë që ndodhet në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi.
- Konsultoni me shitësin ose me një teknik radio/TV me eksperiencë për ndihmë.

Paralajmërim FCC&IC:

- Kjo pajisje duhet të instalohet dhe përdoret në distancë minimale prej 20cm, mes radiatorit dhe trupit.
- Ndryshimet ose modifikimet në këtë pajisje që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

IC-Canada: CAN ICES-003(B) / NMB-003(B)

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licencat të cilat i përmbahen RSS-ve të Inovacionit, Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik të Kanadasë të përjashtuar nga licencat. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferenca.
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar të pajisjes.

Avis d'Industrie Canada: CAN ICES-003 (B)/NMB-003(B)

L'émetteur/récepteur exempt de licence contenu dans le présent appareil est conforme aux CNR d'Innovation, Sciences et Développement économique Canada applicables aux appareils radio exempts de licence. L'exploitation est autorisée aux deux conditions suivantes :

1. L'appareil ne doit pas produire de brouillage;
2. L'appareil doit accepter tout brouillage radioélectrique subi, même si le brouillage est susceptible d'en compromettre le fonctionnement.


2 Soundbar juaj

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfutur plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistroni soundbar tuaj në www.philips.com/support.

Çfarë ka në kuti

Shikoni dhe identifikoni gjërat që janë në kuti:


- Soundbar x 1
- Subwoofer me valë x 1
- Telekomanda x 1
- Kordoni i energjisë (subwoofer) x 2
- Kordoni i energjisë (soundbar) x 2
- Kiti për montim në mur x 1
- Manuali i përdorimit x 1
- Karta e garancisë x 1
- Dokumenti i të dhënave të sigurisë x 1
- Modeli i montimit në mur x 1



- Kordoni i energjisë dhe lloji i spinës ndryshon sipas vendeve.
- Pamjet, ilustrimet dhe vizatimet që tregohen në këtë manual përdorimi janë vetëm për referencë. Produkti i vërtetë mund të ndryshojë në pamje.

Njësia kryesore

Kjo pjesë përmban një përmbledhje të njësive kryesore.



- ① Butoni +/- (**Volumi**)
Rritni ose ulni volumen.
- ② Butoni
- Shtypeni për të zgjedhur modalitetin e Bluetooth
- Mbajeni shtypur për t'i shkëputur të gjitha pajisjet dhe për të hyrë në modalitetin e çiftimit me Bluetooth.
- ③ (**Burimi**)
Zgjidhni një burim për soundbar. Burimi standard është HDMI ARC.
- ④ Butoni (**Standby-On**)
Ndizen soundbar ose kalojeni në gjendje joaktive
- ⑤ **Drita LED e soundbar**


Ndryshoni burimin e luajtjes dhe dritat treguese përpara sipas burimit të zgjedhur. Drita treguese përpara njësive kryesore do të tregojë se cili modalitet është duke u përdorur.

Statusi	Gjendja e LED
AUX	[AUX/USB] E bardhë solide
USB	[AUX/USB] E bardhë që pulson
Standby (Në pritje)	[Standby] E kuqe solide
BT(Bluetooth)	
• Lidhur	[BT] E bardhë solide
• Lidhja	[BT] E bardhë që pulson
OPTICAL (OPTIKE)	[OPT] E bardhë solide
HDMI ARC	[HDMI ARC] E bardhë solide

- ⑥ **Sensori i telekomandës**

Konektorët


Kjo pjesë përmban një përmbledhje të konektorëve të disponueshëm në soundbar.



- ① **Audio in (Hyrje e audios)**
Hyrje audio, për shembull, nga një aparat MP3 (xhek 3.5mm).
- ② **USB**
 - Lidhuni me një pajisje ruajtëse USB vetëm për luajtje të audios.
 - Përditësoni softuerin e këtij produkti.
- ③ **HDMI out (Dalje HDMI) (ARC)**
Lidhuni me hyrjen HDMI (ARC) në televizor.
- ④ **Optical in (Hyrje optike)**
Lidhuni me një dalje audio optike në televizor ose në një pajisje digjitale.
- ⑤ **AC in (Hyrje AC)**
Lidheni me energjinë.
- ⑥ **Vendi i kllapës për montim në mur.**

Subwoofer me valë

Kjo pjesë përmban një përmbledhje të subwoofer me valë.



- ① **AC in**
Lidheni me energjinë.
- ② **Butoni Pair (Çiftim)**
Mbajeni shtypur për ta futur subwoofer në modalitetin e çiftimit.
- ③ **Treguesi i subwoofer**
Përcaktoni statusin mbi bazën e treguesit të subwoofer me valë.

Gjendja e LED	Statusi
Pulsim i shpejtë	Subwoofer në modalitetin e çiftimit
Ndezur	Lidhur / Çiftimi me sukses
Pulson ngadalë	Lidhje / Çiftimi ka dështuar

Telekomanda

Kjo pjesë përmban një përmbledhje të telekomandës.

- ① **Butoni (Standby-On)**
 - Ndizeni soundbar ose kalojeni në gjendje joaktive.
- ② **EQ (Modaliteti)**

Zgjidhni nga katër modalitetet EQ: Film/Muzikë/Zë/Stadium
- ③ **HDMI ARC**

Kalojeni burimin e te lidhja HDMI ARC.
- ④ **Pair / BT (Çiftim / Bluetooth)**

Shtypeni shkurtimisht për të zgjedhur burimin e Bluetooth. Soundbar do të lidhet me pajisjen me të cilën ishte çiftuar për herë të fundit, nëse është e disponueshme. Mbajeni shtypur për 3 sekonda për t'i shkëputur të gjitha pajisjet e Bluetooth dhe për të hyrë në modalitetin e çiftimit.
- ⑤ **◀◀ / ▶▶ (E mëparshme / Tjetra)**

Kapërceni te kënga e mëparshme ose te kënga tjetër në modalitetin USB/BT.

▶▶ (Luaj / Pauzë)

Filloni, ndaloni ose vazhdoni luajtjen në modalitetin USB/BT.

VOL+ / VOL- (Volumi i sistemit)
Rritni / ulni volumin e sistemit.
- ⑥ **Optical (Optike)**

Kalojeni burimin e audios te lidhja optike.
- ⑦ **AUX/USB :**


Kalojeni burimin e audios te lidhja AUX/USB.
- ⑧ **- TREBLE**

Ulni volumin e treble të soundbar tuaj.
- ⑨ **+ TREBLE**

Rritni volumin e treble të soundbar tuaj.

⑩ **- BASS**
Ulni volumin e subwoofer.

⑪ **+ BASS**
Rritni volumin e subwoofer.




Përgatitja e telekomandës

- Telekomanda e dhënë bën të mundur që ta përdorni pajisjen nga njëfarë distance.
- Edhe nëse telekomanda përdoret brenda distancës efektive prej 6 m, përdorimi i telekomandës mund të mos jetë i mundur nëse ka pengesa mes njësive dhe telekomandës.
- Nëse telekomanda përdoret pranë produkteve të tjera që gjenerojnë rreze infrared, ose nëse pranë njësive përdoren telekomanda të tjera me infrared, ajo mund të mos punojë si duhet. Përndryshe, produktet e tjera mund të mos punojnë si duhet.

Ndërrimi i baterive të telekomandës

Për ta hequr kapakun e vendit të baterive, lëvizeni poshtë, vendosni 2 bateri AAA (1,5V) sipas polaritetit të duhur dhe më pas vendoseni përsëri në vend kapakun e vendit të baterive.


- Sigurohuni që anët (+) dhe (-) të baterive përputhen me anët (+) dhe (-) që tregohen te vendi i baterive.



- Mos e vendosni telekomandën mbi ndonjë objekt të lagur.
- Mos e vendosni telekomandën nën dritën direkte të diellit ose pranë burimeve të nxehtësisë tepër të lartë.
- Hiqeni baterinë nga telekomanda kur nuk e përdorni për kohë të gjatë, pasi mund të ndodhë gjërryerje ose rrjedhje e baterisë dhe t'ju shkaktojë dëmtime fizike, dhe/ose dëmtime të pronës, dhe/ose zjarr.
- Mos përdorni bateri të ndryshme nga ato që specifikohen
- Mos i bashkoni asnjëherë bateritë e vjetra me të reja.
- Asnjëherë mos i karikoni bateritë nëse nuk keni konfirmuar që janë bateri të karikueshme.

Vendosja

Vendoseni subwoofer të paktën 1 metër larg nga soundbar, dhe 10 centimetra larg murit. Për të pasur rezultatet më të mira, vendoseni Subwoofer siç tregohet më poshtë.



Masa paraprake lidhur me bateritë

- Sigurohuni që të vendosni bateri me polaritetet e duhura pozitive "⊕" dhe negative "⊖".
- Përdorni bateri të të njëjtit lloj. Asnjëherë mos bashkoni lloje të ndryshme të baterive.
- Mund të përdoren ose bateri të karikueshme, ose jo të karikueshme. Referojuni masave paraprake në etiketat e tyre.
- Bëni kujdes për thonjtë kur hiqni kapakun e baterive dhe bateritë.
- Mos e rrëzoni telekomandën.
- Mos lejoni asgjë që të godasë telekomandën.
- Mos derdhni ujë ose lëngje mbi telekomandë.


Montimi në mur



Shënim

- Montimi i papërshtatshëm në mur mund të shkaktojë aksidente, lëndime ose dëmtime. Nëse keni ndonjë pyetje, kontaktoni shërbimin e klientit në vendin tuaj.
- Para se ta montoni në mur, sigurohuni që muri është në gjendje të mbajë peshën e soundbar.
- Para se ta montoni në mur, duhet të hiqni katër këmbët prej gome poshtë soundbar, përndryshe këmbët prej gome nuk mund të fikohen përsëri.
- Në varësi të mënyrës së montimit në mur, sigurohuni që të përdorni vida me gjatësi dhe diametër të përshtatshëm.
- Kontrolloni nëse porta USB mbrapa soundbar është e lidhur me një pajisje USB. Nëse zbulohet se pajisja USB pengohet nga montimi në mur, duhet të përdorni një pajisje tjetër USB që ka madhësi të përshtatshme.

Gjatësia/diametri i vidës




Lartësia e sugjeruar e montimit në mur
Rekomandohet që të instaloni televizorin para se të montoni soundbar në mur. Me televizorin të montuar paraprkishtë, montoni soundbar 50mm larg pjesës së poshtme të televizorit..



PARALAJMËRIM!

- Për të parandaluar dëmtimet, kjo pajisje duhet të fiksohet mirë në dysheme/mur në përputhje me udhëzimet për instalimin.
- Lartësia e sugjeruar e montimit në mur: $\leq 1,5$ metra.



- 1 Shponi 2 vrima paralele (diametri 3-8mm secila sipas llojit të murit) në mur.
↳ Distanca mes vrimave është:
731mm / 28.78"
↳ Mund të përdorni modelin e dhënë për montimin në mur për t'ju ndihmuar të gjeni pozicionin e shpimit të vrimave në mur.
- 2 Fiksoni upat dhe vidat në vrima.
↳ Mos harroni të lini një hapësirë prej **1,8-2,3mm** mes murit dhe kokës së vidës.
- 3 Fiksoni dy kllapat e murit (x2) mbrapa pajisjes.
- 4 Vareni soundbar në vida.

3 Lidhja

Kjo pjesë ju ndihmon që ta lidhni soundbar me televizorin dhe me pajisje të tjera, dhe më pas ta konfiguroni.

Për informacion rreth lidhjeve bazë të soundbar dhe aksesoreve, shikoni udhëzuesin e shpejtë.

Shënim

- Për identifikimin dhe të dhënat për energjinë, shikoni etiketën e të dhënave mbrapa ose poshtë produktit.
- Para se të bëni ose të ndryshoni ndonjë lidhje, sigurohuni që të gjitha pajisjet të jenë të shkëputura nga priza.

Dolby Audio-Dolby Digital Plus

Dolby Audio-Dolby Digital Plus ju ofron një eksperiencë dëgjimi rrethuese. Për më shumë informacion, vizitoni dolby.com

Përdorimi i Dolby Audio-Dolby Digital Plus

Dolby Audio-Dolby Digital Plus është i disponueshëm në modalitetin HDMI-ARC. Për më shumë informacion për lidhjen, shikoni “Lidhja me **HDMI ARC**”.

- 1 Për të përdorur Dolby Audio-Dolby Digital Plus në modalitetin HDMI-ARC, televizori juaj duhet të mbështetë Dolby Audio-Dolby Digital Plus.
- 2 Sigurohuni që të zgjidhet “No Encoding” për bitstream në daljen e audios digjitale të pajisjes së jashtme të lidhur (p.sh. aparat Blu-ray DVD, televizor etj.).

Shënim


- Eksperienca Dolby Audio-Dolby Digital Plus është e disponueshme vetëm kur soundbar është i lidhur me burimin HDMI-ARC nëpërmjet një kabloje HDMI mbi 1.4.
- Soundbar do të vazhdojë të funksionojë edhe kur lidhet me mënyra të tjera (si për shembull kablo Digital Optical), por ato nuk mbështetën të gjitha veçoritë e Dolby Audio-Dolby Digital Plus. Duke pasur parasysh këtë, rekomandimi ynë është që të lidheni me HDMI për të garantuar mbështetjen e plotë të Dolby Audio.

Lidhja me HDMI ARC

Soundbar juaj mbështet HDMI me kanal kthimi audio (ARC). Nëse televizori juaj është i pajtueshëm me HDMI ARC, mund ta dëgjoni audion e televizorit nëpërmjet soundbar duke përdorur një kabull të vetëm HDMI.

- 1 Në televizor, aktivizoni veprimet HDMI-CEC. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit të televizorit

Konektori **HDMI ARC** në televizor mund të jetë emërtuar ndryshe. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit.



- 2 Duke përdorur një kablo High Speed HDMI, lidhni konektorin **HDMI ARC** në soundbar me konektorin **HDMI ARC** në televizor.




Shënim

- Televizori duhet të mbështetë funksionin HDMI-CEC dhe ARC. HDMI-CEC dhe ARC duhet të jenë të aktivizuara.
- Mënyra e konfigurimit të HDMI-CEC dhe ARC mund të ndryshojnë në varësi të televizorit. Për hollësi rreth funksionit ARC, ju lutem shikoni manualin e përdorimit të televizorit.
- Sigurohuni që të përdorni kablo HDMI që mund të mbështetë funksionin ARC.

Lidhja me portën Optical


- Duke përdorur një kablo optike, lidhni konektorin **Optical out (Dalje optike)** në soundbar me konektorin **Optical out (Dalje optike)** në televizor apo ndonjë pajisje tjetër.




- Konektori optik digjital mund të jetë emërtuar **Spdif** ose **Spdif out**.

Lidhja me portën AUX

- Përdorni një kablo audio 3,5mm në 3,5mm për të lidhur portën e kufjeve të televizorit me portën AUX në pajisje.




- Përdorni një kablo audio RCA në 3,5mm për të lidhur portat e daljes së audios të televizorit me portën AUX në pajisje.



Lidhja me energjinë

- Para se të lidhni kordonin e energjisë AC, sigurohuni që të keni bërë të gjitha lidhjet e tjera.
 - Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është printuar mbrapa ose poshtë pajisjes.
- 1 Lidhni kabllon e energjisë me portën AC~ të pajisjes dhe më pas në një prizë elektrike.
 - 2 Lidhni kabllon e energjisë me portën AC~ të subwoofer dhe më pas në një prizë elektrike.




* Kordoni i energjisë dhe lloji i spinës ndryshon sipas vendeve.

Lidhja me Subwoofer

Lidhja automatike

Lidhni soundbar me Subwoofer në prizat e energjisë dhe më pas shtypni mbi pajisje ose telekomandë për ta kaluar pajisjen në gjendje **ON (Ndezur)**. Subwoofer dhe soundbar do të lidhen automatikisht.



↳ Përcaktoni statusin mbi bazën e treguesit të subwoofer me valë.

Gjendja e LED	Statusi
Pulsim i shpejtë	Subwoofer në modalitetin e çiftimit
Ndezur	Lidhur / Çiftimi me sukses
Pulsim i ngadaltë	Lidhje / Çiftimi ka dështuar



Këshilla

- Mos shtypni butonin **Pair** mbrapa subwoofer, përveçse kur doni të bëni çiftimin manualisht.

Çiftimi manual

Nëse nuk mund të dëgjohet audio nga Subwoofer me valë, lidhni manualisht Subwoofer.

- 1 Shkëputini të dyja kabllot e energjisë të subwoofer dhe soundbar, dhe më pas lidhni përsëri pas 3 minutash.
- 2 Mbani shtypur butonin **Pair** mbrapa subwoofer për 5 sekonda. Treguesi në subwoofer do të pulsojë shpejt.
- 3 Shtypni  në soundbar ose në telekomandë për ta ndezur soundbar duke hyrë automatikisht në modalitetin e çiftimit.
- 4 Treguesi në subwoofer do të qëndrojë ndezur ngjyrë portokalli kur çiftimi të kryhet me sukses.
- 5 Nëse treguesi vazhdon të pulsojë, përsëritni hapat 1-3.



Këshilla

- Subwoofer duhet të jetë jo më shumë se 6m larg soundbar në një vend të hapur (sa më afër, aq më mirë).
- Hiqni çdo objekt mes subwoofer dhe soundbar.
- Nëse lidhja me valë dështon përsëri, kontrolloni nëse ka ndonjë konflikt ose interferencë të fortë (p.sh. interferencë nga një pajisje elektronike) pranë vendit. Hiqini këto konflikte ose interferenca të forta dhe përsëritni procedurat e mësipërme.

4 Përdorimi i soundbar

Kjo pjesë ju ndihmon ta përdorni soundbar për të luajtur audio nga pajisjet e lidhura.

Para se të filloni

- Bëni lidhjet e nevojshme të treguara në udhëzuesin e shpejtë dhe në manualin e përdorimit.
- Kalojeni soundbar te burimi i duhur për pajisjet e tjera.

Ndezja dhe fikja

- Kur e lidhni pajisjen në prizë, pajisja do të jetë në gjendje Standby. Treguesi [Standby] do të ndizet.
- Shtypni butonin  në telekomandë për ose në njësinë kryesore për ta ndezur ose fikur njësinë kryesore.
- Hiqeni spinën nga priza nëse doni ta fikni pajisjen komplet.

Gjendje pritjeje automatike

Njësia kalon automatikisht në gjendje joaktive pas 15 minutash nëse televizori ose njësia e jashtme shkëputet ose fiket.

- Për ta fikur pajisjen komplet, hiqeni spinën nga priza.
- Ju lutemi fiken pajisjen komplet për të kursyer energji kur nuk e përdorni.

Zgjedhja e burimit

- 1 Shtypni vazhdimisht butonin  në njësi ose shtypni butonat **AUX**, **Optical**, **HDMI ARC**, **Pair/BT**, **USB** në telekomandë për të zgjedhur modalitetin e dëshiruar.
Drita treguese në soundbar do të tregojë se cili modalitet është duke u përdorur.


Statusi	Gjendja e LED
AUX	[AUX/USB] E bardhë solide
USB	[AUX/USB] E bardhë që pulson
Standby (Në pritje)	[Standby] E kuqe solide
Pair/BT (Çiftim/Bluetooth)	
•Lidhur	[BT] E bardhë solide
•Lidhje	[BT] E bardhë që pulson
OPTICAL (OPTIKE)	[OPT] E bardhë solide
HDMI ARC	[HDMI ARC] E bardhë solide

Zgjedhja e efektit të ekualizuesit (EQ)

Vendosni modalitete zëri të caktuara paraprakisht që i përshtaten videos ose muzikës tuaj.

- 1 Shtypni butonin **EQ** në telekomandë për të zgjedhur efektet që doni të. Modaliteti standard është **Movie**.
 - **Movie (Film)** (5 drita LED pulsojnë): Krijoni një eksperiencë dëgjimi rrethuese. Ideale për të parë filma.
 - **Music (Muzikë)** (4 drita LED pulsojnë): Krijoni tingull stereo me dy kanale ose shumë kanale. Ideale për të dëgjuar muzikë.
 - **Voice (Zë)** (3 drita LED pulsojnë): Krijoni efekt tingulli që e bën zërin e njeriut më të qartë dhe më të këndshëm për t'u dëgjuar.

- **Stadium** (2 drita LED pulsojnë): Krijoni një atmosferë sikur të ishit duke parë një ndeshje në stadium.




Rregullimi i volumnit

Kur rregulloni volumnin e soundbar dhe të subwoofer, treguesi i statusit do të rritë / ulë sasinë e dritës. Në varësi të ndezjes / pulsimit të dritës përkatëse, përcaktoni nivelin e volumnit të soundbar dhe subwoofer.


Rregullimi i volumnit

- 1 Shtypni +/- në soundbar ose shtypni **Vol+/Vol-** në telekomandë për të rritur / ulur nivelin e volumnit.




Rregulloni volumnin e treble dhe bass

- 2 Shtypni - **Bass +**
Shtypni - **Bass +** në telekomandë për të rritur/ulur nivelin e subwoofer.



- 3 Shtypni - **Treble +**
Shtypni - **Treble +** në telekomandë për të rritur/ulur nivelin e Treble.



Si standard, Bass/Treble është vendosur në 0.

Rivendosja e parametrave të fabrikës

Rivendoseni pajisjen në konfigurimin standard.

- 1 Ndizeni soundbar.
- 2 Mbani shtypur butonat + dhe - për 8 sek. Pasi të gjitha dritat LED të ndizen për 5 sekonda, drita LED [Standby] qëndron ndezur në ngjyrë të kuqe.

Punimi me Bluetooth

Duke përdorur Bluetooth, lidheni soundbar me pajisjen Bluetooth (si iPad, iPhone, iPod touch, telefon Android, ose laptop), dhe më pas mund dëgjoni nëpërmjet soundbar skedarë audio të ruajtur në pajisje.

Çfarë ju duhet

- Një pajisje Bluetooth që mbështet profilin Bluetooth A2DP, AVRCP dhe që ka Bluetooth të versionit 5.0 + EDR.
- Distanca funksionale maksimale mes soundbar dhe një pajisjeje me Bluetooth është rreth 10 metra.

- 1 Shtypni butonin  në njësi ose shtypni butonin **Pair/BT** në telekomandë për ta kaluar soundbar në modalitetin e Bluetooth.
→ Treguesi [BT] do të pulsojë.
- 2 Në pajisjen Bluetooth, ndizni Bluetooth, kërkonti dhe zgjidhni **Philips TAB7207** për të filluar lidhjen (shikoni manualin e përdorimit të pajisjes Bluetooth për mënyrën se si të aktivizoni Bluetooth).
→ Gjatë lidhjes, treguesi [BT] do të pulsojë.
- 3 Prisni derisa të dëgjoni njoftimin me zë nga soundbar.
→ Nëse lidhet me sukses, treguesi [BT] do të qëndrojë ndezur.
- 4 Zgjidhni dhe luani skedarë audio ose muzikë në pajisjen tuaj me Bluetooth.

- Gjatë luajtjes, nëse vjen një telefonatë, muzika ndalon. Luajtja vazhdon kur telefonata mbaron.
- Nëse pajisja juaj me Bluetooth mbështet profilin AVRCP, në telekomandë mund të shtypni  /  për të kapërcyer një këngë, ose shtypni  për të ndaluar/vazhduar luajtjen.

- 5 Për ta shkëputur lidhjen me Bluetooth dhe për të çiftuar një pajisje të re me Bluetooth:

- Mbani shtypur butonin  në pajisje dhe mbani shtypur butonin **Pair/BT** në telekomandë për të shkëputur lidhjen e Bluetooth dhe për të hyrë në modalitetin e çiftimit.




Shënim

- Në një ambient të hapur ku nuk ka pengesa, distanca maksimale e lidhjes mes soundbar dhe një pajisjeje me Bluetooth është rreth 10 metra.
- Nuk garantohej pajtueshmëria me të gjitha pajisjet me Bluetooth.
- Transmetimi streaming i muzikës mund të ndërpritet nga pengesat mes pajisjes dhe soundbar si muri, kasa metalike që mbulon pajisjen, ose pajisje të tjera pranë që punojnë në të njëjtën frekuencë.

Punimi me USB

Kënaquni duke dëgjuar audio në një pajisje USB, si për shembull aparat MP3 dhe pajisje USB flash, etj.

1 Futni pajisjen USB.



- 2 Shtypni vazhdimisht butonin  në njësi ose shtypni butonin **USB** në telekomandë për të zgjedhur modalitetin **USB**.
↳ Drita treguese LED [AUX/USB] pulson në ngjyrë të bardhë.

3 Gjatë luajtjes:

Butoni	Veprimi
▶	Fillo, ndalo ose vazhdo luajtjen
◀◀	Kalo te kënga e mëparshme.
▶▶	Kalo te kënga tjetër

Këshilla

- Ky produkt mund të mos jetë i pajtueshëm me disa lloje të caktuara të pajisjeve ruajtëse USB.
- Nëse përdorni një kablo USB zgjatuese, USB hub ose lexues kartash USB multifunksionale, pajisja ruajtëse USB mund të mos njihet.
- Mos e hiqni pajisjen ruajtëse USB gjatë leximit të skedarëve.
- Ky produkt mund të mbështetë pajisje USB me memorie deri në 128 GB.
- Ky produkt mund të luajë MP3, WAV, FLAC.
- Mbështet një portë USB: 5V --- 500mA.

Punimi me AUX / Optical / HDMI ARC

Sigurohuni që pajisja është e lidhur me televizorin ose pajisjen audio.

- 1 Shtypni vazhdimisht butonin  në njësi ose shtypni butonat **AUX**, **Optical**, **HDMI ARC** në telekomandë për të zgjedhur modalitetin e dëshiruar.
↳ Drita treguese në soundbar do të tregojë se cili modalitet është duke u përdorur.

Statusi	Gjendja e LED
AUX	[AUX/USB] E bardhë solide
OPTICAL (OPTIKE)	[OPTICAL] E bardhë solide
HDMI ARC	[HDMI ARC] E bardhë solide

- 2 Përdoreni pajisjen audio direkt për veçoritë e luajtjes.
- 3 Shtypni butonat +/- (volumi) për të rregulluar volumin sipas nivelit që doni.

Këshillë

- Ndërkohë që jeni në modalitetin **Optical/HDMI ARC**, nëse nuk ka dalje zëri nga njësia dhe treguesi i statusit pulson, mund t'ju duhet të aktivizoni daljen e sinjalit **PCM** ose **Dolby Digital** në pajisjen tuaj burim (p.sh. televizor, aparat DVD ose Blu-ray).

5 Të dhëna për produktin

Shënim

- Specifikimet dhe dizajni mund të ndryshohen pa u njoftuar.

Bluetooth

Profillet e Bluetooth	A2DP, AVRCP
Versioni i Bluetooth	V 5.0
Banda e frekuencës së Bluetooth	2402 - 2480 MHz
Fuqia e transmetuesit	≤ 10 dBm
2.4G Wireless Rrezja e frekuencave/ Fuqia e transmetuesit	2402 ~ 2480 MHz/ ≤ 0 dBm

Seksioni i amplifikatorit

Fuqia output	RMS 260 W @THD≤10%; Max. 520 W
--------------	-----------------------------------

Soundbar

Energjia	100 - 240 V ~ 50/60 Hz
Konsumi i energjisë	30 W
Konsumi në gjendje joaktive	< 0,5 W
USB	5 V ---500 mA
Përgjigja e frekuencës	150 Hz - 20 kHz
Impedanca	8 Ω
Përmasat (Gje x La x Tr)	800 x 65 x 106 mm
Pesha	2,1 kg
Temperatura e punimit	0 °C - 45 °C

Subwoofer

Energjia	100 - 240 V~ 50 - 60 Hz
Konsumi i energjisë	45 W
Konsumi i energjisë në gjendje pritjeje	< 0,5 W
Përgjigja e frekuencës	35 Hz - 150 Hz
Impedanca	3 Ω
Përmasat (Gje x La x The)	150 x 400 x 300 mm
Pesha	4,7 kg
Temperatura e punimit	0°C - 40°C

Telekomanda

Distanca/Këndi	6 m/30 °
Lloji i baterive	AAA (1,5 V X 2)

Formatet audio që mbështeten

HDMI ARC
• Dolby Digital, Dolby Digital Plus, PCM 2ch
Optical
• Dolby Digital, PCM 2ch
BLUETOOTH
• SBC
USB
• MP3, WAV, FLAC

6 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Rrezik goditjeje elektrike. Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni produktin vetë. Nëse keni probleme me përdorimin e produktit, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonit servis. Nëse ende keni problem, merrni ndihmë në www.philips.com/support.

Njësia kryesore

Butonat në njësinë kryesore nuk punojnë.

- Shkëputeni nga energjia për pak minuta, dhe më pas lidheni përsëri.

Nuk ndizet

- Sigurohuni që kordoni AC është lidhur siç duhet.
- Sigurohuni që në prizën AC ka energji.
- Shtypni butonin  në telekomandë ose në soundbar për ta ndezur soundbar.

Zëri

Nga boksi i soundbar nuk del zë.

- Lidhni kabllon e audios nga soundbar në televizor ose në pajisjet e tjera. Megjithatë, nuk ju nevojitet një lidhje audio e veçantë kur:
 - soundbar dhe televizori janë lidhur nëpërmjet HDMI ARC, ose
 - një pajisje është e lidhur me konektorin HDMI in në soundbar.
- Zgjidhni në telekomandë hyrjen e duhur të audios.
- Sigurohuni që soundbar nuk është heshtur.

- Rivendoseni këtë produkt në parametrat e fabrikës (shiko "Rivendosja e parametrave të fabrikës")

Tingulli është i shtrembëruar ose ka eko.

- Nëse luani audio nga televizori nëpërmjet këtij produkti, sigurohuni që televizori është heshtur.

Nga subwoofer me valë nuk del zë.

- Lidheni manualisht subwoofer me njësinë kryesore.
- Rriteni volumnin. Shtypni **Vol+** në telekomandë ose + në soundbar.
- Kur përdorni një prej hyrjeve digjitale, nëse nuk ka audio:
 - Provoni ta vendosni daljen e televizorit në PCM ose
 - Lidhuni direkt me Blu-ray/burime të tjera. Disa televizorë nuk kalojnë audio digjitale.
- Televizori mund të jetë vendosur në dalje audio të ndryshueshme. Kontrolloni që dalja e audios është vendosur në FIXED (FIKSE) ose STANDARD, jo VARIABLE (I NDRYSHUESHËM). Referojuni manualit të përdorimit të televizorit për informacione më të hollësishme.
- Nëse po përdorni Bluetooth, sigurohuni që volumni në pajisjen burim është ngritur dhe që pajisja nuk është heshtur.
- Kur luajtja ngrin dhe në modalitetin Wi-Fi nuk ka zë, ju lutem kontrolloni nëse rrjeti i shtëpisë suaj është normal.

Bluetooth

Pajisja nuk mund të lidhet me soundbar.

- Pajisja nuk mbështet profilet e pajtueshme që nevojiten për soundbar.
- Nuk keni aktivizuar funksionin Bluetooth në pajisje. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes për të parë se si ta aktivizoni funksionin.

- Pajisja nuk është lidhur si duhet. Lidheni pajisjen si duhet.
- Soundbar është lidhur tashmë me një pajisje tjetër Bluetooth. Shkëputeni pajisjen e lidhur, dhe më pas provoni përsëri.

Cilësia e luajtjes së audios nga një pajisje e lidhur është e dobët.

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni pajisjen me soundbar ose hiqni çdo pengesë mes pajisjes dhe soundbar.

Nuk e gjej dot emrin e Bluetooth të këtij aparati në pajisjen time me Bluetooth.

- Sigurohuni që funksioni i Bluetooth është i aktivizuar në pajisjen tuaj me Bluetooth.
- Çiftojeni përsëri aparatin me pajisjen me Bluetooth.

Telekomanda nuk punon.

- Para se të shtypni çfarëdo butoni për kontrollin e luajtjes, më parë zgjidhni burimin e duhur.
- Afrojeni më shumë telekomandën me pajisjen.
- Vendosni baterinë duke i pozicionuar polaritetet (+/-) siç është treguar.
- Ndërroni baterinë.
- Drejtojeni telekomandën direkt në sensorin përpara pajisjes.

Soundbar fiket.

- Kur niveli i sinjalit input të jashtëm të pajisjes është shumë i ulët, pajisja fiket automatikisht pas 15 minutash. Ju lutem rritni volumnin e pajisjes së jashtme.

Subwoofer është në gjendje pritjeje ose subwoofer nuk ndizet.

- Ju lutemi shkëputni kordonin e energjisë nga priza, dhe lidheni përsëri pas 3 minutash për ta resetuar subwoofer.

Trademarks:



The terms HDMI, HDMI High-Definition Multimedia Interface, and the HDMI Logo are trademarks or registered trademarks of HDMI Licensing Administrator, Inc.



Manufactured under license from Dolby Laboratories. Dolby, Dolby Audio, and the double-D symbol are trademarks of Dolby Laboratories Licensing Corporation.



The Bluetooth® word mark and logos are registered trademarks owned by Bluetooth SIG, Inc. and any use of such marks by MMD Hong Kong Holding Limited is under license. Other trademarks and trade names are those of their respective owners.



Roku, the Roku logo, Roku TV, Roku TV Ready, and the Roku TV Ready logo are trademarks and/or registered trademarks of Roku, Inc. This product is Roku TV Ready-supported in the United States, Canada, United Kingdom, Mexico and Brazil. Countries are subject to change. For the most current list of countries in which this product is Roku TV Ready-supported, please email rokutvready@roku.com.



Të dhënat mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara. Ju lutemi vizitoni www.philips.com/support për përditësimet dhe dokumentet më të fundit. Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë.

Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.